



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/41 /2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 32.5 të Statutit të Komunës së Hani të Elezit, neni 15 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2011 merr këtë:

V E N D I M

P Ë R

CAKTIMIN E KRITEREVE DHE SHPALLJE TË KONKURSIT PËR STUDENT

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 01/nr 41/2011 të datës 06/04/2011 për caktimin e kriterëve për bursa për studentët e Komunës së Hani të Elezit për vitin akademik 2010 – 2011.

II

Studentët të cilët konkurojnë për marrje të bursës duhet t'i plotësojnë kriteret:-

- Të jenë student të rregullt të Universiteti Publik të Republikës së Kosovës dhe banorë të Komunës së Hani të Elezit.
- Gjendja ekonomike-sociale e familjes.
- Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse apo ndihme tjetër, përjashtohen vetëm bursat universitare për sukses.
- Studentët që aplikojnë në marrjen e bursës të mos jenë në marrëdhënie pune.
- Studentët të cilat kanë marrë bursë vitin e kaluar, nëse kanë kryer vitin me sukses, i nënshtrohen konkurimit për të drejtën e bursës për vitin vijues.
- Studentët që janë regjistruar për herë të parë në fakultet, vlerësohen sipas rezultatit të testit kombëtar, notës mesatare dhe numrit të provimeve në afatin e Janarit.
- Prioritet kanë studentët e Fakultetit të Mjekësisë, Arkitekturës, Ndërtimtarisë, Gjeodezisë, Shkencave Natyrore (Matematikë, Fizikë, Kimi), Gjuhës Angleze, Fakulteti i Edukimit (Fillor, kulturë, figurative, kulturë muzikore) apo i Arteve (kulturë muzikore dhe kulturë figurative).
- Prioritet kanë studentët të cilët e kanë notën mesatare mbi 8.5.
- Në kushte të njëjta prioritet kanë studentët e : Familjeve të dëshmorëve, Viktimave civile të luftës, Ish- ushtarëve dhe invalidëve të UÇK-s, fëmijët e ish të burgosurve politikë dhe dy e më tepër student të një familje.

III

Mjetet të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kodi ekonomik subvencione dhe transfere vlera e të cilave është prej **10,000.00 €**, që do të përfitojnë **20** (njëzet) studentë për dhjetë muaj nga **50 €** në muaj.

IV

Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bën Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

V

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

VI

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 28.04.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

